



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Infermierë për Shqipërinë, afati i fundit i aplikimeve 1 Shkurt 2018

2018-01-26 16:49:00



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shpalli afatet e aplikimit për pozicionet e punës infermier, fizioterapist dhe teknik imazherie në qendrat shëndetësore dhe spitalet publike në platformën www.infermierepershqiperine.al

Aplikimet do të mbyllen me datë 1 shkurt 2018. Nga sot ka vetëm një mundësi punësimi si infermierë në qendrat shëndetësore dhe spitalet publike- Portali "Infermierë për Shqipërinë". Kjo dritare e re do të ofrojë mundësi punësimi reale sipas një sistemi transparent.

Infermierepershqiperine.al Eshtë porta që i hapet çdo infermieri, kudo në Shqipëri, për të gjetur një vend pune, bazuar në dijet dhe meritat.

Por si do të funksionojë kjo platformë? Cdo i interesuar mund të klikojë

www.infermierepershqiperine.al

Ju nevojiten vetëm 4 hapa për të aplikuar:

- Regjistrohu
- Ngarko dokumentat
- Kërko vendet vakante
- Apliko

Aplikimi kryhet për vendet e lira në bazë qarku. Pra ju mund të aplikoni për të gjitha vendet e lira në qark për pozicionet e punës në qendra shëndetësore apo në spitale.

Pas aplikimit bëhet vlerësimi i dosjes dhe kandidatët që e kalojnë këtë fazë të parë, njoftohen për testimin me shkrim.

Shpallja e datave të testimit bëhet publike në Platformë dhe kandidatët njoftohen elektronikisht për datën dhe vendin e testimit.

Testimi do të ketë dy pjesë:

- Pyetje rreth bazës ligjore që rregullojnë kujdesin shëndetësor, çështjet që lidhen me etikën dhe komunikimin e infermierëve (20 pikë);
- Pyetje rreth kujdesit infermior bazë dhe specialiteteve (50 pikë).

Pas testimit, pikët e grumbulluara për secilin aplikant shpallen në Platformë në rubrikën Shpallje dhe fituesit lajmërohen për të ndjekur procedurën për punësim sipas renditjes në listën e shpallur për cdo QARK.

Në bazë të renditjes së shpallur kush merr më shumë pikë do të ketë mundësinë e zgjedhjes për punësim në shërbimet e kujdesit parësor apo Spitalor.

www.infermierepershqiperine.al

